



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM NË LËMIN E PEMËTARISË - 2017

Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e mjedrës.

Kriteret e përcaktuara:

1. Përkrahen fermerët për mbjelljen e mjedrës në sipërfaqe prej 0.50 ha;
2. Fermerët duhet të kenë mundësi të ujitjes (burimin e ujit);
3. Fermerët duhet të investojnë në vendosjen e sistemit të ujitjes pikë – pikë;
4. Fermerët e përzgjedhur janë të obliguar që të bëjnë analizën e tokës - parcelës që do e mbjellin me mjedër. Nëse këto analiza tregojnë se ajo parcelë nuk i plotëson kriteret për kultivimin e mjedrës, atëherë përfituesi (përfituesja) do të refuzohet;
5. Përparësi do të kenë fermerët që kanë njohuri profesionale në lëmin e bujqësisë (diplomë, dëshmi mbi trajnimet për kultivimin e mjedrave e të ngjashme) dhe që shprehin gatishmëri për pjesëmarrje në trajnime intensive për mënyrën e kultivimit të mjedrave;
6. Aplikuesi - përfituesi nuk mund të jetë në marrëdhënie pune me institucionin (Komunën) që e bën përkrahjen;
7. Nuk përkrahen fermerët që kanë qenë përfitues për ngritjen e sipërfaqeve me pemë të imta-mjedër;
8. Përfituesi duhet të jetë banor edhe të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës.

Dokumentacionet e nevojshme:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin për llogarinë bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e paluejtshme me afat deri në një vit;
- Kopjen e planit.

Data e aplikimit, prej 30.03. deri 12.04.2017.